

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6143  
E martë, 20 tetor 2020  
çmimi 0.40 €

## Kosova regjistron edhe 118 raste të reja me Covid dhe tri viktima

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SELIM SELIMI | FAQE 4-5

## GJYKATA KOMERCIALE DO TA RRRITË SIGURINË JURIDIKE TË TË BËRIT BIZNES



Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se, pasi ka marrë detyrën e ministrit, është zotuar për pavarësi të sistemit të drejtësisë për ta siguruar në mënyrë të plotë ndarjen e pushtetit, duke mos lejuar ndërhyrje politike. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Selimi ka folur edhe për themelimin e Gjykatës

Komerciale, e cila, sipas tij, do të ngrehë sigurinë juridike të të bërit biznes, duke kontribuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të besueshme, efektive dhe të qëndrueshme. Ministri i Drejtësisë ka thënë se është duke u punuar shumë edhe në procesin e vettingut. Selimi ka folur edhe për hartimin e

Projektligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, duke theksuar se ky projektligj, pasi të procedohet për konsultime paraprake dhe me publikun, do të procedohet për aprovim në qeveri, pastaj në Kuvend. "Besoj se gjatë këtij viti do të përfundojë ky proces", ka thënë Selimi

## KOSOVA KA SHËNUAR RËNIE TË RASTEVE TË TRAFIKIMIT TË NJERËZVE

Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës kanë bërë me dije se në Republikën e Kosovës ka rënie të rasteve të trafikimit të njerëzve. Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Trafikimit të Njerëzve, ata kanë vlerësuar se kjo ka ardhur si rezultat i punës së institucioneve të Kosovës dhe bashkëpunimit të nevojshëm me partnerët ndërkombëtarë në këtë drejtim. Sipas tyre, parandalimi i këtij lloji krimi specifik duhet të ndodhë me të gjitha mjetet ligjore që i parashihet legjislacioni në fuqi | FAQE 7



## BE-ja: LAJÇAKU U KEQINTERPRETUA, NDRYSHIMET KUSHTETUESE VLEJNË EDHE PËR BEOGRADIN

FAQE 3



## KULTURË

ANSAMBLI I KËNGËVE DHE I VALLEVE 'ZËRI I KOSOVËS' KTHEHET NGA TIRANA ME TROFE DHE ÇMIME | F. 11



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Kosova regjistron edhe 118 raste të reja me Covid dhe tri viktima

Kosova ka regjistruar të hënën 118 raste të reja me koronavirus, pas marrjes së 828 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar tri viktima. Sipas të dhënave të këtij Instituti, të hënën janë regjistruar edhe 50 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 1 637



Përgjithshëm, Gjilan, një rast nga Spitali i Përgjithshëm, Pejë dhe një rast nga Mjekimi Intensiv Qendror, QKUK).

Numri total i rasteve pozitive është 17 009 raste nga 80 886 persona të dyshimtë me Covid-19 dhe 656 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 50 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 716 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 637.

Rastet e fundit pozitive janë nga: komuna Prishtinë 34 raste, komuna Gjilan 24 raste, komuna Vushtrri 19 raste, komuna Pejë 7 raste, komuna Ferizaj 6 raste, komuna Gjakovë 6 raste, komuna Prizren 5 raste, komuna Shtime 4 raste, komuna Fushë-Kosovë 3 raste, komuna Istog 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Lipjan 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas dhe Suharekë.

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 828 mostra të

marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 118 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tri raste të vdekjes me këtë virus (një rast nga Spitali i

## BIK-u u kërkon autoriteteve të Kosovës të distancohen nga veprimi i ambasadorit Qëndrim Gashi

PRISHTINË, 19 TETOR - Kryesia e Bashkësisë Islame në Kosovë i ka kërkuar të hënën Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, që të distancohet nga veprimi i ambasadorit të Kosovës në Francë, Qëndrim Gashi, i cili ka shpërndarë në rrjetin social "Twitter", postimin e një gazetareje të së përditshmes franceze, "Le Figaro", në të cilën shihet



karikatura e profetit Muhamed. "Për ne si Bashkësi Islame ky akt është i papranueshëm i dënueshëm dhe një veprim i tillë vetëm sa rrit mosdurimin,

urrejtjen dhe mosbesimin ndërnjerëzor, ngaqë cenimi, ofendimi dhe atakimi i tjetrit, e sidomos kur kjo ka të bëjë me çështjen e besimit, nuk paraqet asnjë vlerë", është thënë në deklaratën për opinion të Bashkësisë Islame të Kosovës. Publikimi i karikaturës së profetit Muhamed nga gazeta franceze ka ardhur pas vrasjes së një mësuesi francez nga një

islamist i dyshuar. Mësuesit të historisë, Samuel Paty, i është prerë koka më 16 tetor, jashtë shkollës së tij në periferi të Parisit verior, nga një 18-vjeçar, i cili më pas është qëlluar për vdekje nga policia. Në fillim të këtij muaji, Paty u ka treguar nxënësve të tij karikaturat e profetit Muhamed, në një orë për lirinë e shprehjes, duke zemëruar një numër të

prindërve myslimanë. Bashkësia Islame e Kosovës ka thënë se dënon atë që e ka konsideruar akt kriminal kundër mësuesit francez derisa angazhohet që besimet të mos përdoren për urrejtje dhe mosdurim, por për bashkëjetesë, njohje, respekt dhe dashuri. Myslimanët besojnë se çdo përkrahim i profetit është blasfemi.

## Maqedonia e Veriut paralajmëron masa të reja kufizuese për mbrojtje nga Covid

PRISHTINË, 19 TETOR - Maqedonia e Veriut pritet të aplikojë masa të reja kufizuese pas rritjes së numrit të të infektuarve nga Covid-19. Sipas raportit të Ministrisë së Shëndetësisë, të hënën janë regjistruar 12 viktima, 161 të infektuar dhe 154 të shëruar nga 771 teste të realizuara në 24 orët e fundit. Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut ka propozuar mbylljen e lokaleve të gastronomisë pas orës

23:00, reduktimin e pasagjerëve në transportin publik, orar të ri për punonjësit e administratës, përkatësisht aplikimin e dy turneve në punë apo punë online për kategori të caktuar. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, pret që të ketë rezultate nga këto masa dhe ato që ishin propozuar më parë për mbajtjen e maskës në ambiente të hapura dhe ndalimin e lëvizjes së më shumë personave pas orës

22:00. "Nëse këto masa nuk japin rezultate, atëherë hapi i ardhshëm do të jetë kufizimi i plotë i lëvizjes, përkatësisht ora policore", ka deklaruar Filipçe. Masat e reja të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë duhet të kalojnë në qeveri dhe disa prej tyre edhe në Kuvend. Deri tani në Maqedoninë e Veriut me Covid-19 janë diagnostikuar 23 788 persona. Prej tyre, 846 persona kanë vdekur, 17 392 janë shëruar, ndërsa raste aktive janë 5 550.



## Kurti: Përvoja e shqiptarëve në Zvicër, e nevojshme për rimëkëmbjen ekonomike

PRISHTINË, 19 TETOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se gjatë fundjavës së kaluar ka mbajtur dy tryeza, në Bazel dhe në Aargau, me profesionistë shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Zvicër. "Me bashkëbiseduesit e specializuar në teknologji informative, financa dhe banka, bise-

duam mbi sigurinë kibernetike, vështirësitë dhe mundësitë për investime kapitale, ndikimin e pandemisë në tregjet botërore, kontraktimin e jashtëm në Kosovë etj", ka treguar Kurti. Ai ka thënë se shqiptarët në Zvicër i ka informuar mbi gjendjen aktuale politike dhe ekonomike në Kosovë si dhe

për qeverisjen alternative të LV-së. "Shqiptarët në Zvicër janë integruar në shoqërinë zvicerane duke u bërë integrale për atë. Dija, përvoja dhe investimet e tyre janë aq të vlefshme dhe të nevojshme për rimëkëmbjen ekonomike dhe progresin shoqëror te ne", ka thënë Kurti.



# BE-ja: Lajçak u keqinterpretua, ndryshimet kushtetuese vlejné edhe për Beogradin

PRISHTINË, 19 TETOR - Brukseli vlerëson se deklarata e përfaqësuesit special për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, për ndryshimet e nevojshme kushtetuese, është keqinterpretuar.

Zëdhënësi për Politikë të Jashtme dhe Siguri i BE-së, Peter Stano, i tha "Radios Evropa e Lirë" se duhet bërë dallimi mes asaj që është "percepçion dhe keqinformim, me realitetin e shpjeguar nga zoti Lajçak". "Në këtë rast, është thënë ajo çka është e qartë, dhe zoti Lajçak ka shpjeguar se çfarë ndodh nëse je duke e negociuar një marrëveshje ndërkombëtare. Kur arrin një marrëveshje ndërkombëtare, atëherë duhet të konsiderohen rregullimet e nevojshme ligjore nga qeveria, duke përfshirë edhe nivelin kushtetues, në mënyrë që ta integrojë atë në rendin ligjor dhe kushtetues. Dhe kjo vlen për Kosovën dhe Serbinë", ka thënë Stano.

Të enjten, më 15 tetor, në konferencën për media në Beograd, Lajçak kishte thënë se në një proces serioz negociator, "është e logjikshme që do të duhet të ndryshojë edhe Kushtetuta". Një deklaratë e tillë ka nxitur reagime të shumta në Kosovë, kryesisht kundër çdo mundësie për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Kur bëhet fjalë tek asociacioni, brenga kryesore është te kompetencat të këtij organi. Por, zëdhënësi i Komisionit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Peter Stano, thotë se qëndrimi i BE-së për asociacionin nuk ka ndryshuar. Ai iu referua fjalimit të ish-përfaqësueses së Lartë për Politikë të Jashtme, Federica Mogherini,

në Kuvendin e Kosovës më 2016, ku ajo kishte hedhur poshtë mundësinë që asociacioni të jetë pushtet i ndarë në Kosovë. "Ky asociacion nuk do të jetë qeveri paralele brenda Kosovës dhe nuk do të ketë kompetenca legjislative. Do të formohet brenda kornizës ligjore dhe qeverisëse të Kosovës", pati thënë Mogherini më 6 maj 2016 në Kuvendin e Kosovës. Sipas Stanos, ky vazhdon të jetë qëndrim zyrtar i BE-së.

Mogherini atëbotë pati thënë se asociacioni "do të jetë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese që ofron udhëzime që të sigurohemi se statuti i asociacionit do t'i reflektojë ligjet e Kosovës kur të përpilohet".

Formimi i asociacionit është paraparë me një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar në Bruksel në vitin 2013. Dy vjet më vonë, Kosova dhe Serbia arritën edhe një marrëveshje shtesë për parimet e themelimit të tij, por Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se parimet nuk janë në harmoni me Kushtetutën e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar që akti juridik i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe statuti që zbaton parimet, për të qenë në pajtueshmëri me frymën e Kushtetutës, duhet t'i plotësojë standardet kushtetuese.

Kjo temë ka ndikuar në shtyrjen e dialogut në Bruksel, pasi Serbia po insiston që të diskutohet sërish për asociacionin e Kosova po konsideron si çështje të mbyllur, e cila do të zbatohet pas arritjes së marrëveshjes finale për njohje reciproke.



## Çka është asociacioni i komunave me shumicë serbe në Kosovë?

Asociacioni i komunave me shumicë serbe parashikohet që të mbledhë rreth vetes dhjetë komuna në Kosovë ku shumica e popullsisë janë serbë e të cilat janë: Mitrovica e Veriut, Kllokoti, Parteshi, Ranillugu, Graçanica, Zveçani, Zubin Potoku, Novobërda, Leposaviqi dhe Shtërpca. Sipas marrëveshjes për asociacionin dhe në përputhje me marrëveshjen e parë të Brukselit, objektivat

kryesore të asociacionit janë: ushtron vështrimin e plotë për zhvillimin e ekonomisë lokale; ushtron vështrimin e plotë në fushën e arsimit; ushtron vështrimin e plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkujdesjen sociale; ushtron vështrimin e plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural; aprovon masa për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të

kthyerit në Kosovë; zhvillon, koordinon, lehtëson aktivitete hulumtuese dhe zhvillimore; promovon, shpërndan, dhe avokon për çështjet me interes të përbashkët të anëtarëve të tij dhe i përfaqëson ata, përfshirë tek autoritetet qendrore; vendos marrëdhënie dhe hyn në marrëveshje bashkëpunimi me asociacionet e tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare etj.

## Thaçi dhe Daka flasin për organizimin e zgjedhjeve në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të hënë ka takuar kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Dakën. Presidenti Thaçi dhe kryetarja Daka kanë biseduar për mundësitë e organizimit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në Komunën e Podujevës dhe në Komunën e Mitrovicës së Veriut. "Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit nr.

03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, presidenti i Republikës së Kosovës kishte shtyrë mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në Komunën e Podujevës dhe në Komunën e Mitrovicës së Veriut, me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid-19", është bërë me dije në njoftimin e Presidencës.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, SELIM SELIMI

# GJYKATA KOMERCIALE DO TA RRRITË SIGURINË JURIDIKE TË TË BËRIT BIZNES

Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se pasi ka marrë detyrën e ministrit është zotuar për pavarësi të sistemit të drejtësisë për ta siguruar në mënyrë të plotë ndarjen e pushtetit, duke mos lejuar interferime politike. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Selimi ka folur edhe për themelimin

e Gjykatës Komerciale, e cila, sipas tij, do të ngrehë sigurinë juridike të të bërit biznes, duke kontribuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të besueshme, efektive dhe të qëndrueshme. Ministri i Drejtësisë ka thënë se është duke u punuar shumë edhe në procesin e vettingut. Selimi ka

folur edhe për hartimin e Projektligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, duke theksuar se ky projektligj, pasi të procedohet për konsultime paraprake dhe me publikun, do të procedohet për aprovim në qeveri, pastaj në Kuvend. “Besoj se gjatë këtij viti do të përfundojë ky proces”, ka thënë Selimi

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 TETOR -

“Epoka e re”: Z. Selimi, cilat janë objektivat në mandatin që keni dhe, sa i përket procesit të Vettingut, kur pritët të kemi rezultate konkrete?

Selimi: Pasi kam marrë postin e

ministrit të Drejtësisë jam zotuar për pavarësi të sistemit të drejtësisë, për ta siguruar në mënyrë të plotë ndarjen e pushtetit duke mos lejuar interferime politike. Në lidhje me procesin e vettingut ju njoftoj se është formuar grupi punues për hartimin e modaliteteve dhe skenarëve

për çështje të reformës në sistemin e drejtësisë me qëllim të adresimit të llogaridhënies duke përfshirë edhe vettingun, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 07/15 të datës 22.07.2020. Grupi punues ka nisur takimet menjëherë pas marrjes së vendimit të qeverisë dhe deri

më tani ka mbajtur më shumë se dhjetë takime të përbashkëta të grupeve dhe nën-grupeve, të cilët po punojnë intensivisht nëpër kapituj të veçantë.

“Epoka e re”: E keni potencuar si prioritet themelimin e Gjykatës Komerciale. Sa lëndë apo konteste mund ta presin

verdictin e kësaj gjykate?

Selimi: Gjykata Komerciale do të shërbejë si adresë e vetme dhe e konsoliduar për zgjidhjen e të gjitha kontesteve mes bizneseve në kohë të shpejtë dhe duke ndarë drejtësi të kualitetit të lartë. Gjykata Komerciale do ta ngrehë sigurinë juridike të të bërit

biznes, duke kontribuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të besueshme, efektive dhe të qëndrueshme. Duke e marrë parasysh që ekonomitë e tregut janë dinamike, resurset e Gjykatës Komerciale do të alokohen në kohë reale varësisht numrit dhe llojit të kontesteve të pranuar. Gjykata Komerciale do të funksionojë me një mendësi të shekullit XXI, duke iu përgjigjur kërkesave të bizneseve dhe duke u përqendruar në cilësi dhe efikasitet të shërbimeve.

**“Epoka e re”:** Po ashtu, sa i përket investimeve të huaja, sa raste potencialisht do të trajtohen me fillimin e punës të kësaj gjykate?

**Selimi:** Projektligji për Gjykatën Komerciale parasheh themelimin e Divizionit për shqyrtimin e kontesteve të investimeve të huaja në kuadër të shkallës së parë. Resurset e Gjykatës Komerciale do të alokohen për mbështetje të këtij divizioni po aq sa raste do të pranojnë nga investitorët e huaj.

**“Epoka e re”:** Është paraparë që në kuadër të kësaj gjykate të jetë dhe divizioni për trajtimin e kontesteve të investimeve të huaja. Çfarë trupe do ta përbëjë këtë gjykatë dhe si është pritur kjo nga përfaqësues të afarizmit?

**Selimi:** Përfaqësues të

afarizmit e kanë mirëpritur këtë risi si një garanci e sigurisë ligjore për të investuar në Kosovë. Sipas Programit për Reforma në Ekonomi (2020-2022), e në mbështetje nga Bashkimi Evropian, themelimi dhe funksionalizimi i Gjykatës Komerciale do të kontribuojë në rritje reale dhe të konsiderueshme të Bruto Produktit Vendor (BPV). Përmes rritjes së investimeve të huaja mbi 10 për qind në një periudhë dyvjeçare për shkak të ngritjes së sigurisë ligjore, efektet kumulative afatmesme në rritjen e BPV-së pritet të jenë 2,1 për qind deri më 2022.

**“Epoka e re”:** Sa i përket arbitrazheve karshi Kosovës, a ka Kosova kuadro të mjaftueshme, dhe sa raste janë në arbitrazh?

**Selimi:** Sa i përket procedurës së Arbitrazhit, ju njoftoj se duke pasur parasysh procedurat e përcaktuara me Ligjin e prokurimit për përzgjedhjen e kompanive për përfaqësim dhe mbrojtje të interesit të Republikës së Kosovës në procedurë të Arbitrazhit, të gjitha përgatitjet fillestare, duke përfshirë këtu përgjigjen në padi dhe caktimin e çështjeve procedurale, kompletimi i dosjes me prova bëhet në mënyrë profesionale nga Avokatura Shtetërore. Ndërsa sa i përket përfaqësimit në

arbitrazhin ndërkombëtar, AVSH nuk ka kapacitete të mjaftueshme për ta kryer këtë detyrë edhe pse në mënyrë të qartë Ligji për AVSH-në dhe Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e AVSH-së për përfaqësim në Arbitrazh Ndërkombëtar. Dhe në mungesë të kuadrit, AVSH është e detyruar t’i iniciojë procedurat për përzgjedhjen e kompanisë e cila do të na përfaqësojë në Tribunalin e Arbitrazhit, ashtu siç ka ndodhur deri më tani. Sa i përket shumës në dispozicion, ajo do të ndryshojë varësisht nga rastet dhe kërkesat e arbitrazhit.

**“Epoka e re”:** Sa i përket projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit që është hartuar nga Ministria e Drejtësisë, kur prisni që do të marrë epilog ky projektligj?

**Selimi:** Tashmë kemi themeluar grupin punues për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i cili është gjithëpërfshirës nga të gjitha institucionet relevante që i referohen mbrojtjes dhe kompensimit të viktimave të krimit. Po ashtu, është hartuar versioni fillestar i projektligjit i cili në takimin e parë të grupit punues është trajtuar në parim.

Projektligji pasi të procedohet për konsultime paraprake dhe me publikun dhe trajtimin e komenteve eventuale, do të procedohet për aprovim në qeveri pastaj në Kuvend, besoj se gjatë këtij viti do të përfundojë ky proces.

**“Epoka e re”:** Parashihet edhe mundësia e rritjes së shumës së kompensimit për disa kategori të caktuara të dëmeve të pësuar, për çfarë shume të kompensimit bëhet fjalë?

**Selimi:** Një ndër qëllimet kryesore të projektligjit është edhe ndryshimi, përkatësisht rritja e shumave të kompensimit për: kompensimin e dëmeve materiale; shpenzimet mjekësore dhe hospitalizimi; shpenzimet e varrimit; shpenzimet e humbjes së aftësisë për punë dhe mbajtjes; shpenzimet për shkatërrimin e pajisjeve mjekësore; shpenzimet lidhur me parashtrimin e kërkesës për kompensim, po ashtu edhe kompensimin e dëmeve jomateriale, siç janë dhimbja fizike dhe vuajtja psikike; kompensimi për dhimbjen fizike si pasojë e lëndimit fizik apo dëmtimit të shëndetit; kompensimi për dëmtim të shëndetit mendor; kompensimi për vuajtje psikike; kompensimi për vuajtje psikike për humbjen e anëtarit të familjes.

## OSMANI I JEP MBËSHTETJE GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E RREGULLORES SË RE TË KUVENDIT

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, i ka dhënë mbështetje të plotë Grupit Punues për Hartimin e Rregullores së re të Kuvendit. Gjatë takimit të mbajtur të hënën me anëtarët e grupit për hartimin e kësaj rregulloreje, kryetarja Osmani ka shfaqur besimin se duke u bazuar edhe në draft-rregulloren e hartuar në legjislaturën e kaluar, do të hartohet një dokument funksional, profesional, si dhe do të arrihet unitet politik. “Shpresoj se draft-rregulloren e hartuar në legjislaturën e kaluar do ta analizoni në hollësi. Ku është në rregull, të mbetet ashtu siç është, kurse ku ka nevojë të bëhen ndryshime profesionale, duke u bazuar edhe në praktikën e mira parlamentare. Uroj që puna juaj të kulmojë me miratimin e

Rregullores së re të Kuvendit brenda kësaj legjislature”, ka thënë Osmani, duke shtuar se disa mangësi në rregulloren aktuale kanë ndikuar në punën dhe uljen e besimit të Kuvendit te qytetarët.

Kryeparlamentarja Osmani ka falënderuar NDI-në, KDI-në, si dhe organizatat e tjera joqeveritare për angazhimin e tyre në hartimin e Rregullores së re të Kuvendit.

Ndërkaq kryetari i Grupit Punues për Hartimin e Rregullores së re të Kuvendit, Shkëmb Manaj, pasi ka falënderuar kryeparlamentaren Osmani për mbështetjen e ofruar, përfshirë edhe atë profesionale, e ka paraqitur një rezumë të punës së këtij grupi. Ai ka thënë se në hartimin e Rregullores së re të Kuvendit, përveç çështjeve të tjera, do të merren parasysh edhe



aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese, por edhe rrethanat e reja të krijuara si pasojë e pandemisë Covid-19.

Po ashtu, Manaj ka theksuar se do të jenë të kujdesshëm që kjo rregullore të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës. Pasi që ka vullnet politik, Manaj ka thënë se shpreson që Rregullorja e re e Kuvendit të

votohet në lexim të dytë rreth mesit të dhjetorit të këtij viti.

Edhe anëtarët e këtij grupi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Evgjëni Thaçi- Dragusha, kanë vlerësuar se është shumë e rëndësishme që Kuvendi sa më shpejt ta ketë rregulloren e re, duke marrë parasysh edhe draft-rregulloren e hartuar në legjislaturën e kaluar.

Mbështetje Grupit Punues për Hartimin e Rregullores së re i ka dhënë edhe sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi. “Rregullorja e re po i mungon Kuvendit, marrë parasysh edhe rrethanat e reja”, ka vlerësuar Krasniqi. Në këtë takim është diskutuar edhe për detaje të tjera të rëndësishme që duhet t’i përmbajë Rregullorja e re e Kuvendit.

## Hyrja me pagesë në Prishtinë, sqarohet kryetari Ahmeti

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka dhënë sqarime lidhur me pagesën për ato vetura që hyjnë në kryeqytet. Ai ka renditur disa arsye pse duhet të zbatohet ky vendim



PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se duke filluar nga dhjetori, qytetarët prapë do të ballafaqohen me ndotjen por, sipas tij, kësaj radhe maskat e Covidit do të ndihmojnë në zvogëlimin e sëmundjeve respiratore e të cilat do të ishin edhe më të rrezikshme në kohë të pandemisë. Ai ka thënë se "gjatë periudhës së ndotjes marrim tepër shumë komente nga qytetarët për zgjidhje afatshkurtër e të cilat për ndotje janë të pamjaftueshme për ta zbutur situatën". "Sa i përket ndotjes, ka gjëra të cilat nuk mund t'i ndryshojmë, e ato janë aspektet gjeografike, kushtet

e përgjithshme klimatike dhe kushtet meteorologjike. Por, ka dy gjëra që mund t'i ndryshojmë. Ngrohjen me thëngjill në shtëpi individuale, të cilën po e adresojmë me Termokos, kur në periudhë pesëvjeçare shumica e madhe e pjesës urbane të kryeqytetit do të jetë e kyçur në ngrohjen qendror. E dyta janë numri i veturave në qytet. Meqenëse rrugët janë të ngushta dhe nuk mund të zgjerohen në qendër, atëherë zgjidhje e vetme mbetet ndërtimi i rrugëve alternative (unaza) dhe pagesa e taksës për lëvizje me makinë në pjesë të populluara të qytetit ku ka tollovi dhe që mund të shkaktojnë ndotje", ka


shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se në fundjavë kishte shumë diskutime në rrjetet sociale se si Komuna e Prishtinës do të vendosë rampa në kryeqytet për t'i penalizuar qytetarët e komunave të tjera. "Nuk e di a ka qenë i qëllimshëm ky keqinterpretim, por nuk

është hera e parë që flasim për këtë punë. Pra, përveç parkingut me pagesë, ne kemi shqyrtuar edhe mundësinë e taksës për lëvizje me makinë në qendër. Në gjuhën angleze njihet si Congestion Charge (takse e tollovisë në njëfarë mënyre). Londra është kryeqyteti që e ka rregulluar më së miri këtë

sistem. Nuk ka rampa (laura), nuk ka diskriminime, kur të vendoset kjo politikë vlen për të gjithë dhe implementohet me kamera. Thjesht, në një qytet të vogël ku mund të ecësh në këmbë prej një rreze anë në tjetrën lagje për 30 minuta dhe me ndotje serioze gjatë dimrit, prioritet duhet ta kemi luftimin e përdorimit të panevojshëm të veturave. Prioritet mbi prioritet është shëndeti i qytetarëve. Jemi kryeqytet dhe jemi të lumtur të jemi nikoqir i krejt atyre që vijnë për të na vizituar, për të kryer punë dhe për të jetuar në Prishtinë. Duam veçse ta bëjmë më të jetueshëm dhe më të shëndetshëm kryeqytetin për të gjithë neve. Prandaj krahas kësaj po punohen parkingjet edhe në hyrje të qytetit për ata që nuk duan të mendojnë për parkimin e veturës. Transportin publik do ta kenë falas, me biletën e parkingut", ka shkruar Ahmeti.

## Ministri Selimi: Kosova në rrugën e duhur drejt konsolidimit të sistemit të drejtësisë



PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - "Rishikimi funksional i sundimit të ligjit dhe procesi i llogaridhënies, duke përfshirë vetëpunë, janë tregues se Kosova nga reflektimi po kalon në etapën e implementimit dhe se nuk do të rrijë duarkryq përballë segmenteve që cenojnë sistemin e drejtësisë. Të dyja këto procese janë pjesë e reformës përmes të cilave

synohet ngritja e llogaridhënies, efikasitetit dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor e prokurorial, për t'ua rikthyer besimin qytetarëve në drejtësi. Pra, garantimi i pavarësisë dhe fuqizimi i sistemit gjyqësor e prokurorial është lufta jonë që do ta fitojmë", kështu ka thënë ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, me rastin e lansimit të raportit publik të monitorimit

sistematik dhe tematik të drejtësisë të prezantuar nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Ai ka shprehur mirënjohje për misionin e EULEX-it që po i shërben kauzës së fuqizimit të sundimit të ligjit përgjatë tërë këtyre viteve, përmes këshillëdhënies dhe asistencës për institucionet e drejtësisë në Kosovë. "Pas

leximit të këtij raporti mund të vlerësojmë se Kosova, edhe përkundër sfidave të shumta të cilat vazhdojnë të mbesin, ka bërë progres substancial në një numër të konsiderueshëm të të arriturave dhe standardeve në gjyqësor dhe po ecën me hapa të sigurt drejt konsolidimit të sistemit më kompleks të saj, atij të drejtësisë. Gjetjet objektive dhe rekomandimet specifike

të dala nga ky raport, duhet të jenë udhërrëfyes dhe nxitje për të rritur efikasitetin në sistemin gjyqësor dhe përpjekjet tona për fuqizimin e sundimit të ligjit", ka thënë ai.

Selimi ka shtuar se Strategjia për Sektorin e Sundimit të Ligjit, i cili do të finalizohet së shpejti, do të jetë dokumenti kryesor reformues me rezultate konkrete në praktikë. "Rekomandimet kryesore që dalin nga ky proces, përfshirë masat e propozuara për ta rritur llogaridhënien, efikasitetin dhe transparencën e sistemit janë një përpjekje jashtëzakonisht e rëndësishme që do t'i rregullojë mangësitë që kemi identifikuar në sistem përgjatë këtyre viteve, që nga shpallja e pavarësisë. Suksesi i kësaj përpjekjeje, implementimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit, është thelbësor për të ardhmen e Kosovës dhe sistemin e saj të drejtësisë. Dhe kjo është lufta jonë që do ta fitojmë së bashku", është shprehur ministri i Drejtësisë, Selim Selimi.

## Presidenti Thaçi ndan "Urdhrin e Pavarësisë" për veprimtarin Sali Bislimi

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të hënën i ka dhënë "Urdhrin e Pavarësisë" veprimtarit Sali Bislimi.

"Urdhri i Pavarësisë" u jepet personave që kanë dhënë kontribut të lartë për pavarësinë e Kosovës. "Presidenti i Republikës së

Kosovës, Sh. T. Z. Hashim Thaçi, më dekoroi për veprimtarinë time të kohëve të vështira për lirinë e atdheut tonë të shtrenjtë me

'Urdhrin e Pavarësisë'. Lavdi Kosovës martire!", ka shkruar Sali Bislimi në llogarinë e vet në "Facebook".



Republika e Kosovës ka shënuar Ditën Ndërkombëtare Kundër Trafikimit të Njerëzve

# Kosova ka shënuar rënie të rasteve të trafikimit të njerëzve



Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës kanë bërë me dije se në Republikën e Kosovës ka rënie të rasteve të trafikimit të njerëzve. Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Trafikimit të Njerëzve, ata kanë vlerësuar se kjo ka ardhur si rezultat i punës së institucioneve të Kosovës dhe bashkëpunimit të nevojshëm me partnerët ndërkombëtarë në këtë drejtim. Sipas tyre, parandalimi i këtij lloji krimi specifik duhet të ndodhë me të gjitha mjetet ligjore që parasheh legjislacioni në fuqi

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 TETOR - Përfaqësuesit më të lartë të Kosovës kanë vlerësuar se parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore duhet të ndodhë me të gjitha mjetet ligjore që i parasheh legjislacioni në fuqi. Në konferencën e organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për Ditën e BE-së Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, presidenti, kryeministri dhe ministri i Punëve të Brendshme kanë bërë me dije se shfrytëzimi i Kosovës si rrugë për trafikantët parandalohet me bashkëpunim rajonal dhe evropian. Me këtë rast, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Dita e BE-së kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është ngjarje e rëndësishme në Kosovë dhe më gjerë. “Në këtë ditë vlerësojmë të arriturat, por edhe sfidat që mbesin në këtë fenomen të dhimbshëm për tërë botën. Kosova është vend i origjinës, por edhe i transitit të qenieve njerëzore që trafikohen”, është shprehur Thaçi.

I pari i shtetit ka theksuar se Kosova si shtet i ri ka arritur të krijojë infrastrukturë ligjore që ndihmon në luftimin e trafikimit dhe në rehabilitimin e viktimave. “Duhet të punojmë çdo ditë për të siguruar mirëqenie për qytetarët tanë, në mënyrë që të mos ketë

hapësirë dhe mundësi për zhvillimin e kësaj dukurie negative dhe shumë të rrezikshme për shoqërinë tonë, si dhe duhet të bashkëpunojmë me të gjithë fqinjët dhe me vetë BE-në që ta parandalojmë shfrytëzimin e Kosovës si rrugë për trafikantët”, ka deklaruar Thaçi.

I pari i vendit ka thënë se Kosova i është mirënjohëse Bashkimit Evropian për mbështetjen e ofruar ndaj institucioneve të Kosovës, në parandalimin dhe luftimin e trafikimit. “Ky bashkëpunim është thelbësor, pasi trafikimin mund ta luftojmë vetëm së bashku. Kosova ka kërkuar afrim me organizatat ndërkombëtare, që ta japë kontributin e vet në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore”, ka thënë ai.

Në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i cili ka thënë se parandalimi dhe luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore është prioritet i qeverisë. “Pa dyshim se trafikimi me njerëz është shkelje fundamentale dhe shkelja më flagrante e të drejtave të njeriut, prandaj parandalimi dhe luftimi i trafikimit të njerëzve është prioritet i qeverisë, pasi kjo çështje është në thelb të vet ekzistencës së qenieve njerëzore që i lëkund themelet e shoqërive demokratike dhe themelet e Bashkimit

Evropian”, ka deklaruar kryeministri Hoti.

Shefi i ekzekutivit ka theksuar se ky është ndër problemet me të cilin po përballen të gjithë së bashku në region, në BE dhe më gjerë. Hoti ka theksuar se mundësitë si kjo, por edhe mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë janë të mirëseardhura, që të punohet së bashku në luftimin e migracionit ilegal dhe të informohen qytetarët për rrezikun që na vjen nga kjo dukuri negative. “Pa dyshim se trafikimi i njerëzve i lëndon viktimat në rend të parë, por i lëndon edhe shoqëritë, kufijtë e

shteteve tona, i dëmton ekonomitë tona. Në anën tjetër forcon krimin e organizuar, i bën ato struktura më të fuqishme që t'i vazhdojnë këto aktivitete ilegale”, është shprehur kryeministri Hoti, duke potencuar se ekziston një kornizë e plotë ligjore për luftimin e kësaj dukurie negative, por edhe masat konkrete që kanë ndërmarrë institucionet tona, gjithmonë të harmonizuara plotësisht me ligjet dhe praktikën e BE-së. Sipas tij, parandalimi i këtij lloji krimi specifik duhet të ndodhë me të gjitha mjetet ligjore që i parasheh legjislacioni në fuqi, duhet të identifikohen shpejt dhe të ndëshkohen bartësit e këtij krimi. “Rekomandimet që kemi marrë nga mekanizmat vlerësues ndërkombëtarë për institucionet tona kanë çuar në përgatitjen e planeve të punës dhe veprimeve konkrete në luftimin e kësaj dukurie, andaj sot përgëzoj Policinë e Kosovës dhe të gjitha strukturat që kanë qenë të përfshira në luftimin e kësaj dukurie, organet e rendit dhe të ligjit, të drejtësisë, prokurorinë, gjykatat, shërbimet sociale dhe gjithë aktorët që kanë qenë të angazhuar që nga parandalimi, luftimi dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit”, ka deklaruar kryeministri Hoti. Sipas Hotit, ka nevojë për bashkëpunim më të mirë rajonal dhe bashkëpunim më të mirë ndërkombëtar dhe se puna që ka bërë MPB-ja deri më tash, bashkëpunimet me institucionet ndërkombëtare në këtë drejtim, do të sjellin rezultate të nevojshme. Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka

theksuar se duke iu referuar statistikave të viteve të fundit në Republikën e Kosovës, ka një rënie të rasteve të trafikimit të njerëzve dhe kjo ka ardhur si rezultat i punës së institucioneve të Kosovës. “Për gati dy dekada, parandalimi i trafikimit njerëzor ka qenë një detyrë prioritare e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila ka realizuar angazhimin e saj për eliminimin e këtij fenomeni me masa të shumta, gjithashtu duke caktuar koordinator kombëtar kundër trafikimit dhe krijimin e Autoritetit Kombëtar Kundër Trafikimit që nga viti 2008”, ka thënë Veliu.

Më tej, ai ka shtuar se Policia e Kosovës ka arritur që gjatë periudhës janar-shtator 2020 ta bëjë identifikimin e 11 viktimave të trafikimit të njerëzve, arrestimin e 59 personave të dyshuar për veprat penale të trafikimit dhe veprave që ndërlidhen me trafikimin, si dhe ka paraqitur 18 kallëzime penale në prokuroritë përkatëse për veprat e trafikimit të njerëzve dhe atyre që ndërlidhen me trafikimin. Kurse përfaqësuesi special i BE-së në Prishtinë, Tomas Szunyog, ka deklaruar se lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore nuk është individuale, por duhet të jetë një luftë e përbashkët pasi që është një fenomen global. Ai është zotuar se Bashkimi Evropian do të vazhdojë t'i mbështesë institucionet e Republikës së Kosovës në luftimin e këtij fenomeni negativ. Fushata Kundër Trafikimit të Njerëzve do të zgjasë një muaj dhe synon ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe fuqizimin e ndërgjegjësimit mbi këtë fenomen.



## Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës i shtohet edhe një destinacion i ri

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Nga data 16 dhjetor 2020, ANP 'Adem Jashari' lidhet edhe me qytetin Karlsruhe/Baden-Baden me kompaninë ajrore "Wizz Air" e cila është kompani low cost. "Pas linjave të suksesshme në Aeroportin e Prishtinës si Londra,

Dortmundi, Bazelli, Milano, Memingeni, Vjena dhe Budapesti, tanimë kanë dalë në shitje edhe biletat për destinacionin e tetë me radhë, atë të Karlsruhes/Baden Baden", ka njoftuar Aeroporti ANP 'Adem Jashari'.

Në këtë njoftim theksohet se

një trend i rritjes së fluturimeve ka filluar hovshëm në destinacionin e Kosovës duke shtuar edhe numrin e udhëtarëve si dhe kompanive të reja që operojnë këtu. "Wizz Air" shërben në rreth 140 destinacione në Evropë dhe rreth 40 shtete.



## KEK-u dhe Termokosi angazhohen për furnizim cilësor për ngrohje të kryeqytetit

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 TETOR - Falë angazhimit të KEK-ut dhe të Termokosit, banorët e kësaj qyteti nuk do të kenë probleme me ngrohje nëpër shtëpitë e tyre. Të hënën ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv i KEK-ut, Luigj Imeri, ka nënshkruar aneks kontratë me kryeshefin ekzekutiv të Termokos-it, Arsim Fetahu, me qëllim të vazhdimin të furnizimit të kësaj ndërmarrje me energji termike.

Ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv i KEK-ut, Luigj Imeri, ka thënë se Korporata Energjetike e Kosovës i ka bërë të gjitha përgatitjet për sezonin e dimrit dhe se KEK-u tashmë ka dëshmuar se është faktor stabiliteti sa i përket sektorit energjetik. Ai ka theksuar se në bazë të procedurave, të gjitha remontet e planifikuara kanë rezultuar të suksesshme, me këtë edhe besueshmëria në të gjitha blloqet është rritur në



nivelin e duhur. "Korporata ka dëshmuar edhe në të kaluarën që një shërbim të tillë të cilin e kemi ofruar te qytetarët nëpërmjet juve, është një produkt, i cili, në fakt, ngërthen në vetvete një komoditet te qytetarët. Kjo na bënë me u ndie mirë që qytetarët gjatë kësaj periudhe sa është futur në

funkcion në vitet e kaluara dhe ka qenë e testuar, faktikisht ka dhënë atë rezultat pozitiv te konsumatorët e vendit, kështu që shpresojmë dhe po besojmë se në bazë të përgatitjeve, të cilat kemi bërë deri tash, ky produkt do të vazhdojë të jetë edhe më cilësor ashtu siç ka ndodhur edhe në vitet e

kaluara, përkundrajt sfidës që ka qenë e jashtëzakonshme këtë vit, siç dihet që është pandemia, e cila ka ndikuar, por ne kemi menduar edhe për këtë ditë dhe nuk i kemi ndërprerë aktivitetet", është shprehur Imeri.

Nga ana tjetër, kryeshefi ekzekutiv i Termokos-it, Arsim

Fetahu, ka falënderuar menaxhmentin e KEK-ut për bashkëpunimin, me qëllimin e vetëm që qytetarët e kryeqytetit të kenë furnizim kualitativ me ngrohje. "Ne si Termokos i kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e suksesshëm të sezonit, i cili pritet të ndodhë ditën e nesërme dhe, në saje të përgatitjeve tona dhe bashkëpunimit që kemi pasur dhe do ta kemi me KEK-un, ka munguar vetëm ana formale e nënshkrimit të kësaj aneks kontrate për vazhdimin e ofrimit të shërbimit të ngrohjes nga ana e KEK-ut, dhe kjo është finalizuar dhe besoj se do të jetë në të mirë të qytetarëve", ka thënë Fetahu.

Që nga sezoni ngrohës 2014/2015, në saje të realizimit të projektit të kogjenerimit, NP "Termokos" Sh.A shfrytëzon avullin e Termocentralit Kosova B për prodhimin e energjisë ngrohëse. Lidhja me dy blloqet e TC Kosova B ka mundësuar ngritjen e kapaciteteve teknike deri në 140 MW.



## Mbahet ceremonia e pranim-dorëzimit të detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Doganës

PRISHTINË 19 TETOR (ER) - Të hënën në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganës së Kosovës është mbajtur ceremonia e pranim-dorëzimit

të detyrës nga ish-ushtuesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm, Ibrahim Xhaka, tek ushtuesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Doganës,

Bajram Rexha. "Me qëllim të zbatimit të vendimit 212/2020 të datës 16 tetor 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht të kryeministrit, sot

në Doganën e Kosovës është organizuar ceremonia zyrtare e pranim-dorëzimit të detyrës së drejtorit të përgjithshëm", është thënë në njoftimin për media.





# Hoti takon përfaqësuesit e Departamentit Amerikan të Energjisë, bisedojnë për Ujmanin



PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Driton Selmanaj dhe ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka pritur të hënën në takim delegacionin nga Departamenti i Energjisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili kryesohej nga Matthew Zais, zëvendësndihmës sekretar kryesor, ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett dhe përfaqësues të USAID-it, me të cilët ka diskutuar për implementimin e projekteve të pajtuara në marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë. Kryeministri Hoti me këtë rast, ka falënderuar delegacionin amerikan për ndihmën e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë

dhënë Kosovës, në të gjitha periudhat e shtetndërtimit. Në këtë takim është diskutuar për nevojat ekonomike dhe energjetike të Kosovës, të cilat burojnë nga Marrëveshja e Uashingtonit të 4 shtatorit 2020, e arritur në Shtëpinë e Bardhë dhe implementimin e projekteve të pajtuara për këtë marrëveshje. Ndërsa Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë ka njoftuar se në këtë takim është biseduar për hapat e ardhshëm për një studim të fizibilitetit të menaxhimit të burimeve në Liqenin e Ujmanit. "Delegacioni ndërinstitucional u takua me Hotin për të diskutuar lidhur me marrëveshjen dhe mbështetjen e ShBA-së si dhe për hapat e ardhshëm për një studim të fizibilitetit të menaxhimit të burimeve në Liqenin e Ujmanit", është shkruar në llogarinë e Ambasadës Amerikane në "Twitter".

## Hoti e Osmani diskutojnë për përparimin në reformën e menaxhimit të financave publike

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka pritur të hënën Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës, Besnik Osmani. Me këtë rast, kryeministri Hoti dhe Auditori Osmani biseduan për përparimin në reformën e menaxhimit të financave publike si dhe për aplikimin e standardeve të njohura ndërkombëtare dhe praktikave të mira të auditimit në sektorin publik. "Qeveria do t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit", ka



thënë kryeministri Hoti, duke merren vendime ekzekutive për shtuar se në mbledhjet e t'i adresuar të gjeturat e ardhshme të qeverisë do të auditorit.

## PDK-ja thotë se do t'i zbardhë të gjitha abuzimet e privatizimeve të pronave publike

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 TETOR - Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Gazmend Bytyçi dhe Sejdi Hoxha, kanë mbajtur të hënën një konferencë për media, përmes së cilës ka njoftuar më gjerësisht për punën e komisionit parlamentar për privatizimet, themelimin e të cilit e kishte iniciuar PDK-ja në korrik të këtij viti.

Deputetët Bytyçi dhe Hoxha kanë paralajmëruar se do të nxjerrin me emër dhe mbiemër të gjithë abuzuesit e pronave publike në Kosovë dhe përkatësinë e tyre politike. "Për një kohë të gjatë Partia Demokratike e Kosovës është akuzuar padrejtësisht për abuzime dhe përfitime të paligjshme me procesin e

privatizimit. Madje shumë prej këtyre akuzave kanë ardhur pikërisht nga partitë që më së shumti kanë shfrytëzuar këtë proces për interesa të ngushta të zyrtarëve të saj", ka thënë deputeti Bytyçi.

Ndërkaq deputeti Hoxha ka theksuar se si PDK kanë nisur këtë proces që synon t'i zbardhë keqpërdorimet e mundshme që mund të kenë ndodhur në këtë proces. "Si dhe t'i informojmë drejt të gjithë qytetarët e vendit për çdo lidhje politike që kanë pasur personat të cilët kanë privatizuar asetet shtetërore të vendit tonë", ka shtuar deputeti Hoxha.

Komisioni ka përzgjedhur edhe katër ekspertë profesionalë të cilët do ta ndihmojnë punën profesionale të tij. Për intervistim në këtë komision janë ftuar ish-



ministra, drejtorë të bordeve dhe drejtorë ekzekutivë të Bordit të Privatizimit, si dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut të cilët kanë qenë

pjesë e bordit të AKP-së. Në listën e dëshmitarëve janë propozuar që të jenë edhe ish-kryetari i bordit të AKM-së, Andy

Bearpark dhe drejtorët menaxhues, Herbert Schmidt, Yergen Mendricki dhe Jasper Dick.

## Shtabi Emergjent i Podujevës kërkon nga qytetarët t'i respektojnë masat anti-Covid

PODUJEVË, 19 TETOR (ER) - Në takimin e rregullt të Shtabit Emergjent Lokal, të udhëhequr nga nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, u diskutua për situatën e përgjithshme epidemiologjike në këtë komunë.

Në takimin e shtabit u tha se trendi i rritjes së rasteve me Covid-19, ditët e fundit e ka përfshirë edhe Komunën e Podujevës. "Kemi rritje për 100 për qind të numrit të personave të infektuar, krahasuar me një javë më herët. Lehtësimi i masave dhe mosrespektimi i rekomandimeve, hapja si shkak i fillimit të procesit mësimor, lejimi i ceremonive fetare, lejimi i gastronomisë me orar të plotë dhe numri i bashkatdhetarëve

që kanë hyrë në Kosovë gjatë javëve të fundit janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e numrit të personave të infektuar", ka thënë nënkryetari Rudari.

Ai ka thënë se kjo gjendje e krijuar kërkon rritjen e vëmendjes për secilin prej nesh se virusi është i pranishëm dhe se rekomandimet duhet të zbatohen me përpikëri, si e vetmja mundësi për ta shmangur kthimin në masat shtrënguese, në të cilat ishim më parë. Në Komunën e Podujevës aktualisht janë 47 raste aktive me Covid-19, 657 të infektuar deri tash, 589 të shëruar dhe 21 raste të vdekjes.

Pavarësisht prej gjendjes epidemiologjike, procesi



mësimor në të gjitha shkollat është duke u zhvilluar normalisht, konform vendimeve të Ministrisë së Arsimit.

Shtabi emergjent në këtë komunë u ka bërë thirrje qytetarëve të Komunës së Podujevës që t'i respektojnë

masat anti-Covid, ta mbajnë maskën dhe distancën, t'i dezinfektojnë duart dhe të kujdesen për higjienën.

## Kuvendi i Gjilanit miraton vendimin për ndarjen e 200 bursave për studentë

GJILAN, 19 TETOR (ER) - Kuvendi Komunal i Gjilanit, në një seancë të jashtëzakonshme, kryesuar nga Shpresa Kurteshi-Emini, ka miratuar propozim-vendimin për ndarjen e 200 bursave për studentët e kësaj komune, për vitin akademik 2019/2020, duke u bërë komunë kampion në Kosovë sa i përket mbështetjes së studentëve. Sipas këtij vendimi, 100 bursa, në lartësi prej 60 eurosh, ndahen për studentët e Gjilanit, të cilët studiojnë në universitetet e Kosovës jashtë kësaj komune, ndërsa 100 të tjerë, në lartësi prej 40 eurosh, ndahen për studentët e Gjilanit të cilët studiojnë në universitetet



brenda kësaj komune. Përzgjedhja e studentëve përfitues të bursave do të bëhet nga Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës, në bazë të konkursit të shpallur nga Drejtoria për Arsim dhe kriterëve

për ndarjen e bursave, të miratuara nga komisioni përkatës. Mjetet financiare për bursa ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit nga subvencionet e Drejtorisë për Arsim. Në të vërtetë

Komuna e Gjilanit ka siguruar mjete shtesë, me qëllim të rritjes së numrit të përfituesve.

Duke marrë parasysh numrin e madh të studentëve të cilët studiojnë në universitetet brenda dhe jashtë Komunës së Gjilanit, kërkesat e shumta për bursa si dhe duke marrë parasysh gjendjen e krijuar nga pandemia Covid-19, Drejtoria Komonale e Arsimit, në konsultim me kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet e Financa, ka siguruar mjete shtesë financiare për rritjen e numrit të përfituesve. Për këtë arsye, Kuvendi bëri plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të datës

29.09.2020. Sipas vendimit paraprak, ishte paraprak ndarja e 75 bursave.

Me gjithë vërejtjet e opozitës sa iu përket procedurave të ndryshimit të vendimit paraprak, kriterëve, lartësisë së bursës dhe të tjera, Kuvendi votoi në mënyrë unanime për ndarjen e 200 bursave për studentë.

Gjilani, siç u tha në debat, është komuna e parë në Kosovë që ndan numër kaq të madh të bursave për studentë, madje më shumë se edhe Prishtina, gjë që dëshmon përkushtimin e kryetarit Haziri dhe autoriteteve të këtushme arsimore për të investuar në shkollimin e brezit të ri.

## Begaj nderon me mirënjohje pronarin 'Mulliri i Ri' në Mamushë



MALISHEVË, 19 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka nderuar me mirënjohje "Mulliri i Ri" nga Mamusha, Raif Morinën, në emër të vëllezërve Morina, pronarë të mullirit, për ndihmën e dhënë për Komunën e Malishevës gjatë luftës së fundit. "Në emër të Komunës së Malishevës sot pata nderin ta pres dhe nderoj me mirënjohje zotëri Raif Morina, për kontributin që 'Mulliri i Ri' ka dhënë gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për

Komunën e Malishevës", ka thënë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me rastin e dhënies së mirënjohjes. Raif Morina, që mori mirënjohjen, tha se "kjo mirënjohje është një çmim i madh për familjen e tij, pasi me këtë vlerësohet kontributi i familjes gjatë luftës, kontribut të cilin, si çdo qytetar i vendit, e kemi pasur obligim ta bëjmë". Morina e ka falënderuar Komunën e Malishevës, për këtë mirënjohje dhe vlerësimin e bërë për kohën e luftës.

## Drejtorja për Ekonomi dhe Financa në Prizren bën thirrje për subvencionim të bizneseve

Prizren, 19 tetor (ER) - Drejtoria për Ekonomi dhe Financa në Prizren ka njoftuar biznese të dëmtuara si pasojë e moszhvillimit apo zvogëlimit të aktivitetit ekonomik për shkak të pandemisë se: Certifikata që nuk janë nën hetime (për

bizneseve të dëmtuara si pasojë e moszhvillimit apo zvogëlimit të aktivitetit ekonomik për shkak të pandemisë se: Certifikata që nuk janë nën hetime (për

përgjegjësin e subjektit) nuk është e obligueshme gjatë kësaj faze të aplikimit. "Policia e Kosovës ka njoftuar për grumbullim të madh të qytetarëve për të nxjerrë këtë

dokument, prandaj kjo certifikatë mund të dorëzohet edhe pas përzgjedhjes si përfitues i kësaj mbështetjeje financiare", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



## Fondacioni "Aksioni për Nëna dhe Fëmijë" ndihmon me material mbrojtës QKUK-në

Prishtinë, 19 tetor (ER) - Fondacioni "Aksioni për Nëna dhe Fëmijë" ka dhuruar një donacion, mjete mbrojtëse, në vlerë prej 10 mijë eurosh për Klinikën e Gjinekologjisë dhe të Neonatologjisë. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, ka thënë se ky donacion tregon mbështetjen që shoqata e "Aksionit për Nëna dhe Fëmijë" dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë i kanë ofruar sistemit shëndetësor në Kosovë gjatë këtyre viteve, sidomos gjatë kohës së pandemisë. "Ky donacioni i juaji i sotëm i ofron siguri në punë personelit shëndetësor, i bën më të sigurt në punën e tyre, por edhe rrit besimin, nga ana tjetër, edhe te pacientët, pasi që pacientët, kur e shohin që personeli mjekësor është i mbrojtur me

pajisje mbrojtëse, atëherë kanë një siguri më të madhe se do të marrin shërbime më kualitative", ka thënë Krasniqi. Drejtori ekzekutiv i Fondacionit "Aksioni për Nëna dhe Fëmijë", Vlorian Molliqaj, ka theksuar se po bëjnë përpjekje në forma të ndryshme që të mbledhin fonde, në mënyrë që të sjellin donacione të tjera si ndihmë për punën e profesionistëve shëndetësorë, në betejën me pandeminë Covid-19. "Ne ju falënderojmë për punën përgjatë kësaj periudhe, e cila ka qenë shumë e vështirë. Shpresoj se do të ketë mjete të mjaftueshme dhe do ta kalojmë sa më lehtë këtë sfidë", ka deklaruar Molliqaj. Drejtori i Gjinekologjisë, Jakup Ismaili, ka falënderuar donatorin për ndihmën e



ofruar, ndërsa ka thënë se javën e ardhshme nga AMC do të arrijë edhe një donacion tjetër. Duke folur për bashkëpunimin mes fondacionit "Aksioni për

Nëna dhe Fëmijë" dhe Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, drejtori i Neonatologjisë, Xhevdet Gjoçnovci, ka pohuar se mbështetja e vazhdueshme

nga AMC ka luajtur një rol të rëndësishëm për shëndetësinë në Kosovë, veçmas në këtë periudhë të vështirë, në të cilën po kalon vendi.

## Agron Perquku emërohet drejtor i Inspektoratit Komunal në Vushtrri

VUSHTRRI, 19 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se me propozim të degës së LDK-së në Vushtrri, ka emëruar Agron Perqun, drejtor të Inspektoratit Komunal. "Në një ceremoni solemne, drejtori i deritashëm, Rrahim Ajeti, e ka dorëzuar detyrën. I jam mirënjohës përjetësisht për angazhimin, lojalitetin dhe punën profesionale drejtorit Rrahim Ajeti. Puna e tij dhe e inspektorëve në kohën e pandemisë Covid-19 ka shpëtuar jetë! Do të vazhdojmë bashkë me detyra dhe angazhime të reja. Agron ka qenë pjesë e ekipit të ngushtë në fushatën e fundit lokale, ndërsa përvoja



e tij në dy mandate në Asamblenë Komunale do të tregohet me suksese në angazhimin e ri", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" kryetari Tahiri.

## Mërgimtari Mentor Maliqi ndihmon 13 nxënës të Drenasit me mjete financiare

DRENAS, 19 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim mërgimtarin nga Korrotica e Ulët, Mentor Maliqi, i cili jeton dhe vepron në Gjermani. Në këtë takim mërgimtari Maliqi i ka konfirmuar kryetarit Lladrovci se do t'i ndihmojë 13 nxënës të Shkollës së Mesme

Profesionale "Fehmi Lladrovci" në Drenas të cilët janë në gjendje më të rëndë ekonomike. Maliqi ka thënë se këtë ndihmë për nxënësit e bën për t'ua lehtësuar atyre shkollimin. Kryetari Lladrovci ka falënderuar mërgimtarin Maliqi për këtë ndihmë që po ua bënë nxënësve të Komunës së Drenasit.



## Ansambli i Këngëve dhe i Valleve 'Zëri i Kosovës' kthehet nga Tirana me trofe e çmime

FUSHË-KOSOVË, 19 TETOR (ER) - Kryeqendra e Shqipërisë ishte nikoqire e Festivalit të Talentëve të Rinj "Internacional Shqiptar" i cili u mbajt për nder të 100-vjetorit të Tiranës. Në kushte pandemie, por nën masa mbrojtëse, në këtë festival mori pjesë edhe grupi i dytë i AKV "Zëri i Kosovës" nga Fushë-Kosova. Paraqitja e ansamblit ishte e jashtëzakonshme dhe e veçantë nga grupet e tjera pjesëmarrëse, e për këto të arritura meritore është koreografa Tringa Krasniqi e

cila po bën një punë vetëmohuese me këta artistë të rinj. Në një konkurrencë tepër të fortë dhe me një juri të gjerë profesionale, Ansambli "Zëri i Kosovës" nga Fushë-Kosova u nderua me trofeun e festivalit dhe me dy çmime: Çmimi i parë për kostumet më të bukura dhe Çmimi i dytë për vallen më të mirë të luajtur. Pjesëmarrja në këtë festival do të ishte e pamundur pa ndihmën e Komunës së Fushë-Kosovës, përkatësisht Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.





## Asgjë e keqe s'të vjen nga muzika

Gruaja e re, që thirrej Amla, hodhi kafën në dy filxhanë, pastaj u kthye nga i shoqi, e pyeti:

– Si thua, Progan? Të dalim ta pimë, si gjithnjë, në ballkon?

– Jo, – nëpërdhëmbi ai.  
– Përse?!

Progan Lubani, i hodhi të shoqes një vështrim të shkurtër e kryeneç.

– Nuk e kuptoj, ku është ndryshimi! – tha.

– Jashtë, ka diell, Progan! – ia ktheu ajo. – Dhe kumbulla poshtë nesh sapo ka çelur. A nuk mjafton kaq, për të dalë e për ta pirë kafën në ballkon?!

E tha e qeshur, me sytë që i shkëlqenin nga një ngazëllim prej fëmije miturak. Por qe edhe si një lutje, sepse nuk donte ta lëndonte të shoqin.

– Ti dil dhe pije në ballkon, po deshe, – ia pat ftohtë ai. – Unë do qëndroj këtu ku jam.

Nuk ishin bërë as tre muaj, që patën marrë me qira këtë apartament në katin e tretë. Hapsirat aty qenë të bollshme; kurse dritaret, bashkë me ballkonin, rriheshin nga dielli qysh në lindje të tij.

Ditët e para, ata e bënë zakon ta pinin kafën e mëngjesit bashkë në ballkon; sidomos në fundjavë, kur qenë pushim.

U pëlqente pamja e rë e atij cepi qyteti: rruga, pothuajse e qetë, me fare pak lëvizje makinash; blirët në të dy anët e saj;

dyqani i luleve me trumbat shumëgjyreshe të nxjerra jashtë; kodrina e veshur me mëshkëna atje tej; dhe vija e kurrizit të saj me lakesa, ku në kohë të mirë, e gjelbërta e pyllit, takohej me blunë e qiellit të kthjellët.

Dhe kur kësaj pamje, iu shtuan edhe tingujt e një violine, që vinin nga një apartament në krahun e djathtë, gruas nisi t'i pëlqente edhe më shumë të dilte në ballkon.

Por burri, filloi të mos ndjehej mirë. Atij, iu ngjiz në kokë një llurbë dyshimi, që dikujt, ia kishte shkrepur të luante në violinë për të shoqen e tij, të bukurën Amla. Që nga ballkoni, mund të shikoheshin dritaret e apartamentit nga vinin tingujt muzikor, sepse pallati kishte formën e shkronjës L. Njëra nga ato dritare, mbahej e hapur përgjatë gjithë ditës.

Pogani kish dashur të dinte kush banonte aty, por nuk ia pati dalë

dot ta mësonte. Ai kishte vënë rë, që Amla, sa herë dëgjonte ato simfoni, bëhej disi e heshtur, e menduar, e kursyer në fjalë, apo e zhytur në ëndërrim.

Nëse ai, çelte gojë e thoshte diçka, ajo mjaftohej vetëm me një “po”, ose një “jo”, që i dilte përtueshëm nga buzët. Ajo që e shqetësonte më tepër këtë burrë namuzli, nuk qenë tingujt e violinës, por fakti, që simfonia, në shumicën e rasteve, niste me daljen e tyre në ballkon; dhe fashitej me tu kthyer brenda apartamentit.

Dy javë më parë, Progan Lubani, e pati pyetur të shoqen, nëse e dinte, cili ishte ai cub, që guxonte të niste të luante në violinë sa herë ajo dilte në ballkon. Amla, vetëm sa kishte ngritur supet. Si mund ta dinte?!

– Përse na duhet ta dimë cili është, Progan?! – i pati thënë ajo. – Asgjë e keqe nuk na vjen nga muzika.

Po Amla dinte pjesët, që luheshin: një herë një sonatë nga Amy Beach; një herë tjetër nga Beethoven, Vivaldi, Paganini, e kështu me radhë. Gjithëherë të luajtura mjeshtërisht.

Gjysëm ore më parë, kur Amla ende flinte, Pogani kishte dalë në ballkon vetëm për pak çaste, sa të

dridhte e pinte një cigare.

Me të ndezur cigaren, ai vuri rë, që dritarja në apartamentin tjetër vazhdonte të ishte e hapur.

Për aq minuta sa qëndroi aty, as një tingull violine nuk u dëgjua. Atëherë, i bindur që tingujt e asaj vegle muzikore binin vetëm për të shoqen, Progan Lubani hyri brenda apartamentit dhe vendosi të mos dilte fare me Amlën në ballkon.

– Më pëlqen ta pi kafën në ballkon, Progan, – këmbëngulte ajo. – Përse do, që të më lëshë vetëm?!

– Në ballkon, ti nuk je vetëm, – i tha ai.

Dora, me të cilën mori filxhanin për të hedhur gllënjekën e parë, nisi të dridhej lehtë nga nervozizmi; ndaj, ai e la filxhanin në tryezë, dhe filloi të shkundej duke ngritur e ulur supet; athua se donte të hiqte një barrë të rëndë.zW

– Nëse nuk jam vetëm, me cilin jam, Progan?! – pyeti Amla.

Progan Lubani u rrëqeth. Jo nga pyetja, që i bëri ajo. U rrëqeth nga ai vështrimi i papërbalueshëm i syve të saj të bukur. Amla, e pyeti atë më shumë me sy, se sa me fjalë!

E pyeti me sytë e saj prej fëmije të pafajshëm. Dhe ai, për pak sa nuk u ngrit ta përqafojë plot dashuri e përdëllim. Ta puthte e t'i kërkonte të falur.

Po në çast, sepse ndjeu përbrenda një yshtje të përzier me keqardhje, për ta bërë të shoqen të vuante pa shkak; e bashkë me të shoqen, të vuante edhe vetë ai. Shpesh herë i ndodhte kështu Progan Lubanit. Dhe kurrë nuk kishte mundur ta gjente përse.

Duke i hedhur fjalët rëndë-rëndë, si të rrokullente gurë, ai tha:

– E di vetë ti, me cilin je.

Ajo e kishte një shpraztinë në zemër; por këto fjalë, e bënë të ndjehej edhe më keq. Qe si t'i kishin hedhur në shpirt një lopatë dhë.

Po nuk e bëri veten. Vazhdoi ta lante e dëlirte me vështrimin e syve të saj të mëdhenj e të qashtë. Pastaj, qetë-qetë, vajti e iu ul pranë. Ju afrova ashtu siç mund t'i afrosh një të sëmuri që lyp përkujdesje.

– Unë të dua, Progan, – i tha. – Por ta dishë, që kur dëgjoj tingujt e asaj violine, e sidomos, atë heshtjen mes notave, të dua edhe më shumë. Ato çaste, ti bëhesh frymë e ndryme brenda meje. →



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Liga e Kampionëve fillon me kryendeshjen PSG - United

Me tetë ndeshjet e para të fazës së grupeve fillon sonte (e martë) edicioni i ri i Ligës së Kampionëve. Do të ketë përballje interesante, por kryesorja zhvillohet në Francë në mes të Paris Saint-Germainit dhe Manchester Unitedit



## "Epoka e re"

PARIS, 19 TETOR - Liga e Kampionëve për edicionin 2020/2021 fillon sonte (e martë) me tetë ndeshjet e para të fazës së grupeve. Vëmendja do të jetë në ndeshjen kryesore që zhvillohet në Paris të Francës në mes të nënkampionës së Evropës, Paris Saint-Germainit dhe Manchester Unitedit. Në këtë përballje do të shohim lojtarë të tillë si Neymar dhe Mbappe të luajnë kundër Fernandesit dhe Pogbas. Kampionët e Francës në këtë ndeshje hyjnë pas fitores 4-0 ndaj Nimes Olympique në Ligën 1. Ndërsa nën anën tjetër e mposhti, po me rezultat bindës Newcastle United (4-1). Paris Saint-Germain për këtë ndeshje ka probleme me shumë lëndime. Leandro Paredes, Mauro Icardi, Thilo

Kehrer dhe Juan Bernat mungojnë për shkak të lëndimeve, kurse në dyshim janë Marquinho, Julian Draxler dhe Marco Verratti. Mbrojtësi Colin Dagba ishte pozitiv për koronavirus dhe, nëse del negativ në testin e dytë, do të jetë i gatshëm, kurse Danilo Pereira është në vetizolim. Edhe trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer, do të jetë pa qendërmbrojtësit Phil Jones dhe Axel Tuanzebe, pas ata janë të lënduar. Në Grupin H do të përballen edhe Leipzig me Basaksehirin. Një ndeshje e fortë do të zhvillohet në Angli, e vlefshme për Grupin D. Chelsea e Frank Lampardit e pret skuadrën e Sevillas, e cila e ka fituar Ligën e Evropës në edicionin e kaluar. Ndërsa në Romë, Lazio e shqiptarëve e pret Borussia Dortmundin.

## GRUPI E

21:00 Chelsea - Sevilla  
21:00 Rennes - Krasnodar

## GRUPI F

18:55 Zenit - Club Brugge  
21:00 Lazio - Borussia Dortmund

## GRUPI G

18:55 Dynamo Kyiv - Juventus  
21:00 Barcelona - Ferencvaros

## GRUPI H

21:00 Paris Saint - Germain - Manchester U.  
21:00 Leipzig - I.Basaksehir

## SHKURT

### Ferizaj dhe Istogu i mësojnë të martën kundërshtarët në garat evropiane

Kampioni i Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave, Ferizaj, dhe nënkampioni, Istogu, të martën mësojnë kundërshtarët e raundit të tretë në Kupën Evropiane, njofton FHK-ja. Për herë të parë ndodh që dy skuadra të Kosovës të jenë në raundin e tretë të një gare evropiane. Ferizaj nis garimin prej raundit të tretë, kurse Istogu në raundin e dytë e eliminoi Vushtrrinë. Shorti për raundin e tretë do të tërhiqet të martën, prej orës 11:00, në Vjenë, njofton EHF-ja. Ndeshjet e raundit të tretë luhen më 14-15 e 21-22 nëntor.

### Mediumi italian: Askush si Daku

Futbollisti më në formë në Superligë pa asnjë dyshim është sulmuesi i Ballkanit, Mirlind Daku. Ai ka realizuar 12 gola për "portokallinjte" pas vetëm gjashtë xhirove në Superligë. E për këtë ecuri, "bomberi" ka marrë lëvdata nga media e njohur italiane "Calcio Style". Sipas medias në fjalë, nuk ka asnjë lojtar tjetër në kontinentin e vjetër që krahasohet me lojtarin nga Gjilani. Kujtojmë se Daku ka ardhur te Ballkani si huazim nga skuadra kroate Osijek.

### Onbashi largohet pas gjashtë vjetësh nga KFF Mitrovica

Trajneri Seidi Onbashi është larguar nga skuadra e KFF Mitrovica. Lajmin e ka konfirmuar vetë Onbashi, i cili për gjashtë vjet ishte pjesë e kësaj skuadre. "Pas gjashtë vjetëve në KFF Mitrovica si trajner vendosa të largohem nga klubi ku patëm shumë suksese dhe fituam shumë tituj e Kupa. Falënderoj lojtarët, trajnerët, stafin mjekësor, kryesinë e klubit, në veçanti kryetarin Hajrulla Haxhiu për këto vite të kaluara së bashku. Klubit i dëshiroj suksese të reja në Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare", ka shkruar Onbashi në profilin e vet në "Facebook".

### Duka, Rejës: Fito dy ndeshjet e nëntorit

Presidenti i FSHF-së, Armand Duka, ka hedhur poshtë zërat për një largim të teknikut të kuqezinjve, por i dërgon atij një mesazh të qartë se do dy fitore në ndeshjet e nëntorit dhe vendin e parë në grupin e Ligës së Kombeve. Dy barazimet në dy ndeshjet e fundit në Ligën e Kombeve, bën që të ketë pakënaqësi për teknikun italian, por Duka është i bindur në punën e 75-vjeçarit. "Nuk ka asnjë plan rezervë për Edi Rejën dhe trajneri do ta vijoje punën. Steka e Kombëtares është rritur dhe tashmë nuk kënaqemi më me humbje 1-0, por duam dy fitore në ndeshjet e nëntorit dhe ta mbyllim në vend të parë grupin tonë në Ligën e Kombeve", tha Duka.

## Më 12 dhjetor sërish do të ngrehë titujt kampionë

LONDËR, 19 TETOR - Boksieri britanik Anthony Joshua, kampion bote në peshën e rëndë (kategoritë IBE, WBO dhe WBA), ka konfirmuar se më 12 dhjetor do të mbrojë titujt në një duel ndaj bullgarit Kubrat Pulev. Kjo

sfidë do të zhvillohet në stadiumin "O2 Arena" të Londrës, duel i shtyrë për shkak të pandemisë Covid-19 (ishte planifikuar për në qershor). "Më 12 dhjetor unë do të ngrehë sërish lart në qiell titujt kampionë bote në

peshën e rëndë dhe ju garantoj se ato do të jenë sërish në Britaninë e Madhe", ka thënë Joshua në një intervistë për "Sky Sports". "O2 Arena" është një stadium me histori, ku kanë rënë të gjithë rivalët e mi. Më vjen

keq që këtë herë nuk do të ketë fansa edhe pse shpresoj se, duke respektuar normat e sigurisë, ta sigurojmë praninë e disave. Kjo do të vendoset më vonë. Unë respektoj çdo rival. Respektoj edhe Pulevin", ka deklaruar Joshua.



## Java e Superkupës në basketboll

PRISHTINË, 19 TETOR - Tetë skuadrat e Superligës do të jenë në aksion dhe do të luftojnë për trofeun e Superkupës. Po të dielën në Pejë është finalja Bashkimi - Kosova Home Prishtina, dy skuadrat më të mira në konkurrencën e femrave. Takimet e para çerekfinale zhvillohen më 21 tetor në Gjakovë, ku do të përballen Rahoveci-Trepça dhe Sigal Prishtina-Vëllaznimi dhe fituesit do të luajnë në gjysmëfinale. Më 22 tetor do të takohen Golden Eagle Ylli-Ponte Prizreni dhe Peja-Bashkimi. Këto takime zhvillohen në



Prizren dhe fituesit do të përballen në gjysmëfinale. Ndërkohë, gjysmëfinalët do të zhvillohen më 23 tetor në Suharekë. Peja është qyteti mikpritës i finaleve. Fillimisht nga ora 14:00 do të ndeshen Bashkimi - Kosova Home Prishtina në finalen e femrave, kurse nga ora 17:00 do të zhvillohet finalja në


konkurrencën e meshkujve. Në palestër duhet të jenë maksimumi 50 persona nga të dyja skuadrat dhe zyrtarët e tjerë. Të gjitha klubet janë të obliguara ta respektojnë Udhëzuesin për Rikthimin në Fushat e Basketbollit, që u është dërguar klubeve dhe ndodhet edhe në uebsajtin zyrtar të FBK-së.

### ORARI

17:00 Rahoveci - Trepça  
19:30 Sigal Prishtina - Vëllaznimi  
17:00 Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni  
19:30 Peja - Bashkimi  
Gjysmëfinalja I: 17:00 Fituesi i Grupit A-B  
Gjysmëfinalja II: 19:30 Fituesi i Grupit C-D  
Finalja femrat: 14:00 Bashkimi - Kosovahome Prishtina  
Finalja meshkujt ora 17:00

## Zbulohet plani i Cityt për transferimin e Messit në janar

BARCELONË, 19 TETOR - Leo Messi vazhdon të jetë temë dite në shtypin britanik. Disa media angleze shkruajnë se ka përpjekje të reja nga Manchester City për t'i siguruar shërbimet e "yllit" të Barcelonës, kontrata e të cilit me klubin "blaugrana" përfundon verën e ardhshme. Meqenëse në qershor "Pleshti" do të largohet me parametër zero, Barcelona mund ta pranojë ofertën e Citizens që në janar, për t'i mbushur sadopak arkat e klubit. E ndërsa "Daily Mirror" thekson se Barcelona me shumë mundësi do ta humbje "yllin" e saj sezonin e ardhshëm, "Daily Star" shkon shumë më tej dhe tregon se



Manchester City mund të bëjë një ofertë prej rreth 15 milionë sterlinash (rreth 17 milionë euro) për ta marrë Messin kur të hapet tregu i transferimeve dimërore. City, në këtë rast, do ta shfrytëzonte situatën e vështirë ekonomike të klubit "blaugrana".

Nga ana e tij, Leo Messi e ka bërë të qartë në një intervistë të gjatë në të cilën, ndër të tjera, premtoi se do të përkushtohet maksimalisht për ta ndihmuar ekipin që të arrijë suksese këtë sezon. Ai nuk dëshiron të dëgjojë asgjë tjetër për largimin e tij.

## Van Dijk: Rikthehem edhe më i fortë

Virgil van Dijk premtan se do të kthehet më i fortë se më parë, pas konfirmimit nga Liverpooli se mbrojtësi ka nevojë për operacion të ligamentit të gjurit. Qendërmbrojtësi holandez u përplas me portierin e "Toffees", Jordan Pickford, gjashtë minuta

pas nisjes së derbit të "Merseyside". "Tani jam plotësisht i përqendruar në shërimin tim dhe do të bëj gjithçka që të kthehem sa më shpejt që të jetë e mundur. Pavarësisht prej zhgënjimit, unë jam besimtar i patundur. Brenda vështirësisë qëndron

mundësia dhe me ndihmën e Zotit do të sigurohem që të kthehem më mirë dhe më i fortë se më parë. Në futboll, ashtu si në jetë, gjithçka ndodh për një arsye. Është shumë e rëndësishme të ruash qetësinë dhe përqendrimin e të mos biesh

moralisht", ka thënë Van Dijk. Me mbështetjen e bashkëshortes, fëmijëve, familjes dhe të gjithëve në Liverpool, jam gati për sfidën që më pret. Do të doja t'ju falënderoja të gjithëve për mesazhet mbështetëse, kjo do të thotë shumë për mua dhe familjen

time. Tani do të bëj gjithçka për t'i mbështetur shokët e mi të skuadrës në çdo mënyrë që mundem përpara javëve shumë të rëndësishme, ndërkohë që do të punoj për riaftësimin tim ditë pas dite. Do të kthehem", ka shtuar Van Dijk.

### SHKURT

#### Vazhdon bojkotimi i futbollit në Shqipëri

Klubet e Superligës në Shqipëri nuk dëshirojnë të zbrapsen. Edhe mbledhja e kësaj të hëne, ku presupozohej se do të merrej vendimi për të hequr dorë nga bojkoti dhe për ta nisur menjëherë kampionatin, nuk ka prodhuar lajmin e shumëpritur. Liga Profesioniste e Futbollit nuk lëviz nga llogorja: vendos ta vazhdojë bojkotin deri në plotësimin e kërkesave nga ana e qeverisë. "Liga vendosi që bojkoti të vazhdojë derisa qeveria t'i plotësojë kërkesat tona. Nëse nesër do të ketë tym të bardhë nga takimi në ministri, qëndrimi do të ndryshojë. Ne ndryshojmë mendim dhe vendim vetëm nëse na plotësohen kërkesat. Vetëm kanë filluar bisedimet, nuk kemi marrë asnjë vendim. Nesër kemi takim dhe presim të kemi një propozim për të zgjidhur këtë çështje. 10 klube duan që të mos fillojë dhe asnjë nuk do të fillojë pa u plotësuar kërkesat", u shpreh Edvin Libohova, president i Ligës.

#### Broja në formacionin e javës në Holandë

Sulmuesi Armando Broja ishte protagonist në fundjavën e Eredivisie, duke shënuar dy herë në fitoren 2-0 të Vitesse në transfertën kundër Den Haag. Me këtë paraqitje, sulmuesi shqiptar në pronësi të Chelsea ka fituar edhe elozhet e mediave holandeze. Këto të fundit i kanë rezervuar atij një vend në formacionin më të mirë të javës. Një vlerësim i rëndësishëm për Armando Brojën, që mund të kthehet me shënjestër të përmirësuar për ndeshjet e nëntorit të kombëtares shqiptare në Ligën e Kombeve.

#### Juve e dëshiron Alaban

Skuadra e Juventusit po interesohet për mbrojtësin e Bayern Munchenit, David Alaba. Futbollisti austriak ende nuk e ka rinovuar kontratën me kampionët e Evropës dhe Gjermanisë, prandaj klubi italian nga Torino po mundohet të përfitojë nga ky rast. Interesim për Alaban ka shfaqur edhe Barcelona dhe Manchester City. 28-vjeçari është pjesë e Bayernit nga viti 2010 dhe në këtë mënyrë ai me klubin gjerman arriti të fitojë dy herë Ligën e Kampionëve.

#### Çeferin: Evropiani në një vend të vetëm, VAR-i duhet përmirësuar

Presidenti i UEFA-së, Aleksander Čeferin, në një intervistë me Movistar pranoi se Evropiani i 2021 nuk është në rrezik, por zhvillimi i ndeshjeve në shumë vende do të shfuqizohet. "Ne jemi të sigurt se do të luhet por, ndoshta, vetëm në një vend", ka thënë ai. Sa i përket formulës "Final Four" të Ligës së Kampionëve, Čeferin theksoi: "Është një opsion, por pas vitit 2024. Formati i vitit të kaluar u favorizua nga Koronavirusi, por ishte interesant. Një finale me tetë skuadra është e vështirë për shkak të kalendarit, por një 'Final Four', me një javë futboll, do të ishte një ngjarje e shkëlqyeshme që mund të organizohet në qytete të mëdha", ka shtuar Čeferin. "VAR? Ndhmon futbollin por, gjithashtu, mund ta dëmtojë atë. Nuk ka kthim prapa, por ka shumë gjëra për t'u përmirësuar".

## NJOFTIM

Njoftojme te gjith klientet se Kompania " Ledri & Lisi " Sh.P.K. me seli ne Prizren ka mare vendim te shuaj biznesin me numer unik te regjistrimit 811329566 dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillim te procedures se likuidimit. Njoftojme te gjith klientet qe kane raporte Kreditore – Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afat prej 30 ditore nga data e shpalljes ne gazete.

## OBAVESTENJE

Obavestavamo sve kliente da Tvrtka " Ledri & Lisi " Sh.P.K. u Prizrenu donjelo odluku da ugasi biznis po Br registra 811329566 ujedno imenovao likvidatora o sprovodjenju postupka likvidacije.Svi klijenti koji imaju izvestaje o kreditu-duzniku u ovoj kompaniji obavestavaju se u roku od 30 dana od dana objavljnja u novinama.

## ANNOUCEMENT

All clients are to be informed that the Compni " Ledri & Lisi " Sh.P.K. in Prizren has come to the quit its business with registry 811329566 The Company has appointed a likidator who is going to Oversee the likuidator process. All cliente whu have the mortgages-mortgage accounts in this company are kindly recuest to show up witin 30 days starting from the day newspaperammouncement publication.

## N j o f t i m

Njoftojmë të interesuarit se me datën 29 tetor 2020 (E Enjte) me fillim në orën 12:00 Inxh. i dipl. Hysni L. Gashi mbron punimin e Masterit me titull: "Aftësia inbibuese dhe ndikimi i stresit të kripërave të NaCl te fara e grurit". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► Shkurte Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat shf " Fadil Hisari " Prizren.

► Valbone Berisha shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Shipron Osmanaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasen I - IX shf " Naim Frasheri " Kobaje.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.



Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/ \_\_\_\_\_

Më: \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ ( MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

## KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2020/2021

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	Orë
1	SHFMU" Habib Berisha" në Gurbardh	Gjuhë angleze	Zëvendësim i lehonisë	1	20
2	SHFMU" Visar Krasniqi" në Drenoc	Punëtor teknik	I lirë	1	40

## I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- Certifikata e lindjes

## II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr 04/L-032 dhe , Ligji Nr. 03/L-068) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

❖ Kriteret e kualifikimit: Për vendin e punës mësimdhënës të programit fillor kërkohet kualifikimet: Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit ( 300 ECTS); sistemi katërvjeçar; Bachelor ( katërvjeçar 240 ECTS) ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

❖ Kriteret e kualifikimit për punëtorë teknik Përgatitja shkolla fillore. Detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorit teknik -Bënë mirëmbajtjen teknike të objektit, Kujdeset për mirëmbajtjen e gjelbërimit të ambientit të brendshëm dhe jashtëm. -Kryen punë të tjera me interes për shkollën sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës Vërejtje : Për pozitën punëtor teknik zbatohet puna provuese prej 6 muaj komfor nenit 15 të Ligjit të Punës.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përfaqshëm.

## III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

## Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa originalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

## Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **19.10.2020 më datën:02.11.2020**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit,përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.





Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrarë. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema kadareane*. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikes, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku një tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi

Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë vepër unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivura e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.


Dr. Arben Fetoshi

4<sup>99</sup> €



Triptikon arbëresh

Arben Veselaj



Bujar Salihu (1972) është nga Pogradja e Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Në vitin 1990 filloi studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës por, për shkak të rrethanave politike, u detyrua t'i braktisë ato dhe Kosovën. Që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ka botuar përmbledhjet poetike: *Në xipat e vetmisë* (1994), *Më pak se jetë* (1997), *Skeleti i dallëndyshes* (2002). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është fitues i disa çmimeve letrare. *Linga e heshtjes* është libri i tij i katërt.

26 vjet më parë, në moshën 22 vjeçe, një libër me poezi e botoi në dy gjuhë, në shqip dhe në frëngjisht. Pas botimit të librit të parë më 1994, i botoi edhe dy të tjerë dhe, me disa autorë shqiptarë, foli në disa gjuhë pasi disa përgatitës hartuan antologji me poezi shqipe. Veçantitë e tij letrare i kemi vënë re qëmoti, por edhe i kanë zënë ngoje Ali Podrimja, Shaip Beqiri, Mustafë Xhemaili, Arif Molliqi, Faik Shkodra, Xhemail Ahmeti, Nexhat Rexha e ndonjë tjetër që tash s'po na kujtohet. Prandaj, duke pasur veçanti më tepër se disa poetë të tjerë e duke qenë poezia e tij objekt krahasimi me atë të A. Tufës, L. Leshanakut, A. Balës, B. Cufajt, V. Berishës, R. Zekthit, I. Belliut, D. Gashit, M. Mavrajt, Xh. Beqirit, L. Arapit, Rr. Paçarizit, E. Hatibit etj., disa poezi të Bujar Salihut i kemi botuar në revistën *Akademia*. Me kalimin e viteve, ai duke shtuar veçantitë gjuhësore dhe tematike në poezi e ne duke veneruar krijimet e tij, këtë herë i botojmë këtë libër, i cili një shok tjetër e ka të rrallë. Lexojini të gjitha poezitë e këtij libri, por mos harroni t'i lexoni dy herë poezitë *Dita jote e fundit*, *Buka*, *Eja të pajtohemi*, *Veshkat e vyshkura*, *Hija e qershisë*, *S'e mbajte premtimin*, *E përvaishme*, *Puthje*, *Mbrëmë*, *Në vend të pasthënies* dhe t'i mësoni përmendësh sepse fjalët, fjalitë, figurat, temat dhe motivet e tyre ju duhen shumë në jetën e përditshme.

Sh. B. Armagedoni


4<sup>99</sup> €



Linga e heshtjes

Bujar Salihu

Bujar Salihu



LINGA E HESHTJES (poezi)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

